



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.01, datë 14.01.2022

PËR CAKTIM TË PËRKOHSHËM

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, gërma “a” të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”, miratuar me Vendimin nr. 64, datë 15.04.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e ndryshuar, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. **Znj. Irena Çunoti**, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, të caktohet përkohësisht si prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Korçë.
2. Znj. Irena Çunoti, do të ushtrojë funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Korçë, nga data 20.01.2022 – 19.04.2022.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, znj. Irena Çunoti do të paguhet me pagën e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Korçë.
4. Të njoftohen për këtë vendim znj. Irena Çunoti, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Korçë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
GENT IBRAHIMI

ANËTAR
SOKOL STOJANI

ANËTAR
ELOIDA GOXHI

ANËTAR
ZEQIR HODA

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

ANËTAR
SANDËR BECI

ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
LUDOVIK DODAJ

ANËTAR
TARTAR BAZAJ